



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL	
Nr.Br.No.	01 / 712
DAT.DT.	11. 07. 2023
PRISHTINË - A	

Memorandum i Bashkëpunimit

Dexis Consulting Group, zbatues i Programit për Drejtësi Komerciale, (Programi), një program shtatëvjeçar i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) në Kosovë;

dhe

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK);

Në vijim të referuara së bashku si "Palët", deklarojnë bashkëpunimin e tyre në këtë Memorandum Bashkëpunimi si më poshtë:

Hyrje

Programi përfshin aktivitete që kanë për qëllim të mbështesin drejtësinë komerciale në Kosovë. Programi dhe KGJK bashkëpunojnë në një fushë të gjerë aktiviteteve, ku ndër të tjera përfshihet edhe mbështetja për funksionalizimin e Gjykatës Komerciale.

Ky Memorandum i Bashkëpunimit adreson mbështetjen e Programit për procesin e digjitalizimit në Gjykatën Komerciale, e cila fillimisht ka nisur me menaxhimin e lëndëve dhe arkivimin e tyre përmes regjistrave të shkruar me dorë, dhe mbështjelljen e lëndëve me libralidhës. Që nga fillimi i punës së saj në muajin Gusht të vitit 2022, Gjykata ka siguruar një lidhje me Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK). Kështu, sikurse edhe gjykatat e tjera, Gjykata Komerciale vazhdon të mirëmbajë një sistem të dyfishtë dosjesh, në letër dhe elektronik.

Ekzistojnë disa mundësi për të përmirësuar efikasitetin, besueshmërinë dhe llogaridhënien e Gjykatës Komerciale përmes mbështetjes së digjitalizimit. Këto mundësi janë propozuar në dokumentin e Vlerësimit të digjitalizimit për Gjykatën Komerciale, në të cilin Programi i USAID për Drejtësi Komerciale bazon përkrahjen e saj në procesin e digjitalizimit të Gjykatës Komerciale. Prandaj, digjitalizimi nga Programi do të fokusohet në mbështetjen e SMIL-it si burimi kryesor i të dhënave për proceset plotësuese për vendimet e administrimit dhe menaxhimit. SMIL-i shërben si burim qendror i të dhënave përmes së cilit furnizohet depoja e të dhënave (Data warehouse) me të dhëna për qëllime raportimi.

Ky Memorandum i Bashkëpunimit synon të harmonizoj planet e palëve në angazhimin e përbashkët për procesin e digjitalizimit në Gjykatën Komerciale.



Neni I

Qëllimi

1. Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është lehtësimi i zbatimit të gjetjeve nga Vlerësimi i Digjitalizimit të Gjykatës Komerciale, nëpërmjet angazhimit të eksperteve të fushës dhe resurseve tjera të nevojshme, që përfshinë:
 - 1.1 Përkrahjen e KGJK-së duke u mbështetur në aktivitetet e dala nga Vlerësimi mbi Digjitalizimin e Gjykatës Komerciale.
 - 1.2 Mbështetjen në regjistrimin e lëndëve të Gjykatës Komerciale në sistemin e SMIL, nga Programi.
 - 1.3 Lehtësimin e mbështetjes së Programit vis-à-vis qasjes së Gjykatës Komerciale në raporte komplekse menagjeriale.
 - 1.4 Lehtësimin e mbështetjes së Programit në rritjen e sigurisë së shënimeve dhe komunikimeve digjitale.

Neni II

Zotimet e Programit

1. Programi synon të përkrahë KGJK-në në digjitalizimin e proceseve në Gjykatën Komerciale përmes masave të mëposhtme:
 - 1.1 Moduli i për menaxhimin e tregueseve të performancës (Key Performance Indicator - KPI)
 - 1.2 Zgjerimi i Platformës së të Dhënave të Hapura (ODP) për raportim dhe cilësinë e të dhënave.
 - 1.3 Mbrojtja ose klasifikimi i të dhënave.
 - 1.4 Vërtetimi (Authentication) nëpërmjet platformës së Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) EDI.
 - 1.5 Aplikacioni celular për njoftim.
 - 1.6 Lidhja e Regjistrimit të Llogarive Bankare (RLLB) me SMIL.

Neni III

Mbështetje e Programit për zbatimin e procesit të digjitalizimit dhe regjistrimin e lëndëve në Gjykatën Komerciale.

1. Mbështetja e Programit përfshinë angazhim financiar e ndarë të mbuloj angazhimin e stafit dhe praktikantëve të programit, duke filluar nga 15 Qershori i 2023 deri në zbatimin e plotë, por jo më vonë se 31 Dhjetori i 2023.



2. Mbështetja financiare e ndarë nga Programi do të mbuloj angazhimin e stafit dhe nënkontraktorëve që do të bëhet përmes Programit, për aktivitetet në lidhje me digjitalizimin e Gjykatës Komerciale. Kjo përkrahje është e planifikuar nga 15 Qershori i 2023 deri në zbatimin e plotë por jo më vonë se 31 Dhjetori i 2024. Mbështetja e financiare e Programit është subjekt i zbatimit të rregullave dhe politikave që zbatohen nga programi.
3. KGJK do të ofrojë hapësirat e nevojshme dhe të sigurta për veglat softuerike të ofruara nga Programi.

Neni IV

Përgjegjësitë kryesore të stafit të Programit

1. Përgjegjësitë kryesore të stafit të Programit janë si vijon:
 - 1.1. Skanimi i dosjeve të lëndëve të Gjykatës Komerciale dhe vendosja e tyre në SMIL.
 - 1.2. Sigurimi i cilësisë së të dhënave në SMIL gjatë skenimit të vendimeve dhe korrigjimet teknike të tyre sipas nevojës.
 - 1.3. Kryerja e veprimeve në SMIL për lëndë sipas veprimeve të ndërmarra në formë manuale.
 - 1.4. Sigurimi i kualitetit të dhënave që përfshihen në platformën SMIL nga shfrytëzuesit e Programit dhe veprimet tjera sipas procedurave manuale të përfunduara nga stafi dhe gjyqtarët në Gjykatën Komerciale.

Neni V

Zotimet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës

1. KGJK-ja u mundëson stafit të Programit qasje të drejtpërdrejtë në SMIL për të kontrolluar cilësinë e të dhënave dhe regjistrimin e lëndëve sipas procedurave gjyqësore.
2. Identifikimi dhe angazhimi i burimeve ekzistuese në kuadër të departamenteve të TIK-ut, Statistikave, Komisionit për Administrimin e Gjykatave, si dhe Komisionit për Monitorimin e Zbatimit të Strategjive të KGJK-së dhe kornizës rregullative në funksion të cilësisë dhe shkëmbimit të dhënave.
3. Zgjerimi i grupit ekzistues teknik punues për cilësinë e të dhënave të SMIL-it dhe ndërlidhjes me platformën e hapur për të dhëna.
4. Mbajtja e takimeve të nivelit të lartë sa herë që është e nevojshme për të adresuar gjetjet dhe sugjerimet e grupeve teknike punuese.
5. Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore sipas nevojës dhe me rekomandim të grupeve teknike përgjegjëse për zbatimin e digjitalizimit në Gjykatën Komerciale.
6. Funkcionalizimi dhe zgjerimi i Inter-operabilitetit/ndërveprueshmërisë së SMIL-it me platformën e hapur të shënimeve (ODP).



7. Ndërlidhja e cilësisë së të dhënave të përfshira në platformën SMIL-it me mekanizmat përkatëse të vlerësimit të performancës së gjyqtarëve dhe procedurat disiplinore.

Neni VI

Kohëzgjatja

Ky Memorandum i Bashkëpunimit është i zbatueshëm nga data e hyrjes në fuqi, e deri më 18 Shkurt 2026, përveç nëse ndërpritet paraprakisht, ose nëse nuk vazhdohet me shkrim nga të gjitha Palët.

Neni VII

Monitorimi dhe Vlerësimi

Nëse është e nevojshme, njëra palë mund të kërkojë takime për të diskutuar çështjet, për të vlerësuar progresin e arritur deri tani dhe për të koordinuar hapat e ardhshëm.

Neni VIII

Konfidencialiteti

1. Asnjë pjesëmarrës nuk mund të ia kalojë ose të zbulojë ndonjë informacion konfidencial tek ndonjë person ose organizatë e tretë përveç nëse:
 - 1.1 Merret pëlqimi me shkrim nga pjesëmarrësi(ët) tjetër; dhe/ose.
 - 1.2 Informacioni është publikuar; dhe/ose.
 - 1.3 Zbulimi i tij kërkohet me ligj.

Neni IX

Efektet e Memorandumit të Bashkëpunimit

1. Palët e kuptojnë se ky Memorandum i Bashkëpunimit nuk përbën ndonjë detyrim ligjor apo marrëveshje detyruese sipas ligjit ndërkombëtar, të Kosovës, të SHBA-së apo ndonjë ligji tjetër.
2. Palët më tej kuptojnë se USAID-i nuk është palë në këtë Memorandum të Bashkëpunimit. Të gjitha veprimet e ndërmarra nga Qeverisë së Shteteve të Bashkuara



të Amerikës sipas këtij Memorandumi të Bashkëpunimit janë subjekt i disponueshmërisë së fondeve.

3. Ky Memorandum i Bashkëpunimit nuk krijon asnjë detyrim apo zotim të fondeve nga USAID-i apo Qeveria e SHBA-së. Çdo detyrim ose zotim i tillë do të ndikohet nëpërmjet marrëveshjeve të veçanta.

Neni X

Nënshkrimi

Palët, secili duke vepruar përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë bërë që ky Memorandum i Bashkëpunimit të nënshkruhet në emër të vetin, dhe nga data e përcaktuar më poshtë të paraqitet në tri kopje në gjuhët anglisht, shqip dhe serbisht. Në rast të ndonjë paqartësie ose konflikti midis versioneve, mbizotëron versioni në gjuhën angleze.

Neni XI

Ndryshimi dhe data e hyrjes në fuqi

1. Ky Memorandum i Bashkëpunimit mund të ndryshohet me pëlqimin reciprok të palëve nënshkruese.
2. Ky Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.

Nënshkruar në emër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Albert Zogaj, Kryesues



Nënshkruar në emër të Dexis Consulting Group

Chris Thompson, Drejtor

07.07.2023